

Aneksi nr. 1 - Formula e Pikëzimit për programin e strehimit social “Subvencionimi i interesave të kredisë”

	SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT “SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË”	Pikët
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25
I.	Nuk disponon banesë në pronësi	10
II.	Banesa në rrezik shembje	3
III.	Banojnë në banesa të mbi populluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	3
IV.	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore	3
V.	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
VI.	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike	3
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25
I.	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë; ku përfshihen dhe vajzat nëna	5
II.	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore	1
III.	Familjet me më shumë se katër fëmijë	5
IV.	Familjet e reja, ku mosha e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç	7
V.	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	7
1.3	KUSHTET SOCIALE	25
I.	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave	4
II.	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç	4
III.	Familje e mbetur e pastrehë për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve	1
IV.	Emigrantë të rikthyer, punëtorë emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatë apo personat me mbrojtje plotësuese	3
V.	Familjet e policëve të rënë në detyrë	3

VI.	Punonjës i repartit të ndërhyrjes së shpejtë FNSH, punonjës i repartit RENEA, punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin	2
VII.	Viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme të trafikimit	3
VIII.	Anëtar e komunitetit Rom dhe Egjiptian	3
IX.	I mitur në konflikt me ligjin sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të mitur	1
X.	Individ që i përket komunitetit LGBTI	1
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25
i.	Familje me të ardhura mesatare që janë familjet me të ardhura mujore midis 100 dhe 120 për qind e të ardhurave mesatare	9
ii.	Familje me të ardhura të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore midis 70 dhe 100 për qind e të ardhurave mesatare	9
iii.	familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70 për qind e të ardhurave mesatare	7
iv.	Familje pa të ardhura	0
TOTALI PIKË		100

Në total sistemi i pikëzimit përmban 100 pikë, ku çdo kriter përmban 25 pikë.

Kushtet ekonomike, në bazë të të cilave grupohen familjet, sipas të të ardhurave përcaktohen bazuar në të dhënat e përditësuara të Instituti të Statistikave (INSTAT) sipas nenit 2, pikës 45 të ligjit 22/2018 “Për strehimin Social” i ndryshuar.

Aneksi nr. 2

Struktura familjare	Struktura e apartamentit	Niveli Maksimal i të ardhurave	Niveli Minimal i të ardhurave referuar pageses minimale sipas VKM-Nr. 776, datë 19.12.2025	Vlera Maksimale e Kredisë sipas shkresës së Ministrisë
1	Grasoniere	83,192	44,400	5,594,220
2	1+1	111,157	44,400	6,837,380

3-4	2+1	147,738	44,400	10,069,596
5+	3+1	165,932	44,400	12,431,600

Aneksi nr. 3 - Lista e dokumentacionit

a) Për të dhëna personale të aplikantit:

- i) certifikatë e lindjes së aplikantit/Certifikatë personale/Letërnjoftim, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
- ii) vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit.

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës “a”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar:

- i) Vërtetimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në emër të aplikantit dhe anëtarëve madhorë të familjes së tij, sipas certifikatës familjare, si dhe të bashkëjetuesit/es, që nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ii) Vërtetimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për secilin nga anëtarët madhorë të familjes që vërteton se nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit, përveç rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të forcës madhore.
- iii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi.
- iv) aktverifikim nga njësia vendore për:
 - banesat në rrezik shembjeje;
 - rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
 - banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.
- v) Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
- vi) akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.

c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës “b”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar:

- i) certifikatë familjare;
- ii) vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara shoqëruar me vërtetim nga zyra e përmbarimit për masën e pensionit ushqimor.

ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës “c”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar:

- i) vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;
- ii) vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;
- iii) dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;

- iv) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;
- v) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;
- vi) urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje;
- vii) vetëdeklarim nëse individ/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;
- viii) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- ix) vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
- x) vërtetim me certifikatë familjare se individ i përket kategorisë vajzë-nënë.

d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës “ç”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar:

- i) Vërtetim page nga punëdhënësi shoqëruar me:
 - vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012)
 - vërtetim për pagimin e kontributeve si individ nga Drejtoria Rajonale Tatimore.
- ii) Vërtetim si individ i peregjistruar në emër të aplikantit dhe anëtarëve të familjes së tij, sipas certifikatës familjare, si dhe të bashkëjetuesit/es, që vërteton se individ nuk figuron i regjistruar për qëllime tatimore. Për individët të cilët figurojnë të regjistruar për qëllime tatimore duhet të sjellin dokumentacion shtesë:
 - a) Ekstrakt historik nga QKB.
 - b) Pasqyra financiare për vitin kalendarik të shkuar për personat e vetëpunësuar e njehsuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore
 - c) Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore nëse kanë detyrime të papaguara, për personat e vetëpunësuar.
- iii) vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe vërtetim mbi pagesëne aftësi të kufizuar;
- iv) vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë. Për individët të cilët nuk janë në marrëdhënie pune duhet të paraqesin vërtetimi regjistrimi si punëkërkues në Zyrën e Punës përkatëse.
- v) vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension.

Shënim!

Dokumentacioni i lartpërmendur gjenerohet nëpërmjet portalit E-Albania/ institucioneve përkatëse.

Për familjet të cilat kanë lidhur martesë me shtetas të huaj ose individë të cilët kanë vendlindjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pranohet vetëm dokumentacioni i siguruar nga Institucionet e kësaj të fundit